

LIGJ

Nr. 10384, datë 24.2.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9870, DATË 04.02.2008 “PËR STANDARDIZIMIN”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9870, datë 04.02.2008 “Për Standardizimin”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për standardet e hartuara e të adoptuara në të gjithë sektorët e ekonomisë”.
2. Ky ligj nuk zbatohet për standarde të hartuara, të adoptuara dhe të miratuara nga shoqëri, agjensi dhe/ose organizata të pavaruara”.

Neni 2

Në nenin 8 pika 1 hiqet shprehja”me përjashtim të atyre të fushës së telekomunikacionit”.

Neni 3

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9

Përfaqësimi

DPS-ja përfaqëson Republikën e Shqipërisë në Organizatën Ndërkombëtare të Standardizimit (ISO), në Komisionin Ndërkombëtar të Elektroteknikës (IEC), në Sektorin e Standardizimit të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU-T), në Komitetin Evropian për Standardizimin (CEN), në Komitetin Evropian për Standardizimin në fushën e Elektroteknikës (CENELEC) dhe në Institutin Evropian të Standardeve të Telekomunikacionit (ETSI)”.

Neni 4

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

1. “Forumi Kombëtar i Standardizimit” është organ pranë DPS-së. Anëtar i këtij forumi mund të bëhet çdo person fizik dhe/ose juridik që ushtron veprimtari në Republikën e Shqipërisë.
2. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e Forumit Kombëtar të Standardizimit, si dhe të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të tij përcaktohen me rregullore të veçantë të hartuar nga DPS-ja dhe të miratuar nga bordi drejtues i saj”.

Neni 5

Në nenin 19, shkronja “dhe” ndryshohet si më poshtë:

dh) kuotat nga anëtarësimi në Forumin Kombëtar të Standardizimit pranë DPS-së”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë mbas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

JOSEFINA TOPALLI